

## Afishim Publik

# Rikonstruksioni dhe përmirësimi i infrastrukturës së rrugës "Adria nga rotonda e Urës së Dajlanit deri tek Rotonda pranë Stacionit të Trenit"

Bashkia Durrës, në kuadër të zhvillit urban të qytetit dhe përmirësimit të infrastrukturës publike, kërkon të realizojë projektin e zbatimit për objektin: "Studim Projektim per Rikonstruksioni e rrugës "Adria" nga rotonda e Ures se Dajlanit deri tek Rotonda prane Stacionit te Trenit", parashikuar si pjesë e zhvillimit të Planit të Përgjithshëm Rregullues miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr 24, datë 05.03.2021.

Kërkesa për zhvillimin e projektit, bazohet në nevojën për rizhvillimin dhe përmirësimin e aksit kryesor të hyrjes së qytetit te Durrësit, referuar:

- Planin e Përgjithshëm Vendor të miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr.24, datë 05.03.2021.
- Në vizionin dhe strategjine e Bashkisë Durrës për zhvillimit urban dhe infrastrukturor të qytetit.

Sistemi Infrastrukturor i Planit të Përgjithshëm vendor ka për qëllim :

- a) Krijimin dhe përmirësimin e aksesit të zonave të reja dhe atyre ekzistuese urbane, brenda dhe jashtësistemit urban;
- b) Përcaktimin e territorit për ndërtimin e infrastrukturave publike;
- c) Përcaktimin e territorit per ndërtimin e infrastrukturave nëntokësore kyresore publike.

## OBJEKTIVAT

Sistemi Infrastrukturor i Planit të Përgjithshëm vendor ka për qëllim :

- a) Krijimin dhe përmirësimin e aksesit të zonave të reja dhe atyre ekzistuese urbane, brenda dhe jashtësistemit urban;
- b) Përcaktimin e territorit për ndërtimin e infrastrukturave publike;
- c) Përcaktimin e territorit per ndërtimin e infrastrukturave nëntokësore kyresore publike dhe nënprojektet si më poshtë:

- **Nenprojekti 1: Shtresat Rrugore**
- **Nenprojekti 2: Bordurat dhe Kunetat**
- **Nenprojekti 3: Trotuaret**
- **Nenprojekti 4: Korsite e bicikletave**
- **Nenprojekti 5: KUZ**
- **Nenprojekti 6: KUB**
- **Nenprojekti 7: Rrjeti FU**
- **Nenprojekti 8: Rrjetet e tjera (Elektrik, Telefoni, Internet etj)**
- **Nenprojekti 9: Sinjalistika Rrugore**
- **Nenprojekti 10: Gjelberimi dhe mobilmi urban**
- **Nenprojekti 11: Ndertimi dy zonave rekreative**
- **Nenprojekti 12: Terminali i Ri i Autobuzeve te linjave nderqytetase**